



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-03/24

Datë: 26. 06. 2024, ora 14<sup>00</sup>

### PROCESVERBAL

Mbledhja e Tretë e Rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 26 Qershor, 2024, në orën 14<sup>00</sup>, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Ruzhdi Shehu - kryetar i Komunës-Kryesues i KKSB-së,
2. Rasim Syla - komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Shkëlzen Shehu - përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
4. Leonita Jasiqi - përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
5. Ariola Krasniqi - zyrtare për Barazi Gjinore, dhe
6. Driton Syla - "Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi", Junik, dhe
7. Dukagjin Lllolluni - përfaqësues nga OJQ.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i Komunës - koordinator i KKSB-së z. Besart Tofaj, zyrtari për Pylltari në Komunën e Junikut z. Tafë Tofaj, dhe përfaqësuesi i FSK-së, z. Amrush Morina.

Në këtë mbledhje munguan; Albestrim Rexhepi - përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Arsim Shehu - përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, Arbër Gjota - përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike, Xhavit Velijaj - drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Xhavit Gaxherri - kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut, Zejnepe Gaxherri - kryesuese e Komitetit për Komunitete, Qamil Jasiqi - përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara, Afërdita Shehu - kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, dhe Imer Krasniqi - përfaqësues i Bashkësisë Islame.

Mbledhjen e Tretë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024 e shpalli të hapur koordinatori i KKSB-së z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe nga anëtarët e Këshillit kërkoi miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Miratimi i dorëheqjes së anëtarit të KKSB-së,
3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
4. Prerja ilegale e pyjeve, gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm, dhe
5. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u miratua me shtatë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

### **Pika e Parë të Rendit të Ditës** **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Koordinatori z. Besart Tofaj kërkoj shqyrtimin e procesverbalit të kaluar, i cili me shtatë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KKSB-së.

### **Pika e Dytë e Rendit të Ditës** **Miratimi i dorëheqjes së anëtarit të KKSB-së,**

Z. Besart Tofaj njoftoj se kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut, z. Xhavit Gaxherri ka ofruar dorëheqjen e tij nga ky Këshill, dhe tha se kjo kërkon miratimin nga KKSB-ja, ndërsa hodhi në votim këtë kërkesë, e cila u miratua nga anëtarët e KKSB-së.

### **Pika e Tretë e Rendit të Ditës** **Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut**

Z. Rasim Sylja tha, nga takimi i fundit dhe deri më tani gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut në përgjithësi është e qetë. Kemi pasë gjithsejtë gjashtë vepra penale, të cilat të gjitha janë ndriçuar. Sa i përket rregullimit të trafikut kemi pasë aktivitete të ndryshme dhe janë shqiptuar rreth dyqind gjopa në trafik nga policia e Kosovës.

Kemi disa projekte për sezonën e Verës, dhe disa planifikime, të cilat së bashku me institucionet tjera duhet t'i zhvillojmë. Tani është ardhja e bashkatdhetarëve, ahengjet, zjarrvëniet, dhe do të punojmë në rregullimin e trafiku, dhe besoj që do të bëhet një zgjidhje për parkingjet sikurse vitin e kaluar, siç është hapësira të stacioni i autobusëve, parkingu i Komunës, dhe ai të Tregu i Gjellbërt.

Do të bëjmë një njoftim apo një fushatë vetëdijesuese që t'i orientojmë qytetarët të këto vend-parkingje publike. Pra, nuk kemi pasë ndonjë rast që dëmton sigurinë në Komunën e Junikut, por kanë qenë gjashtë raste për tre muaj, të cilat janë në procedurë, dhe për dy nga këto raste personat që kanë kryer këto vepra kanë qenë në ndalim nga policia.

Znj. Leonita Jasiqi pyeti dhe kërkoj të di lidhur me rastin e një veture me tabela të Serbisë, që ka qarkulluar në lagjen "Agim Ramadani", dhe që ka ngritur shqetësim të qytetarët!

Z. Rasim Sylja tha, me këtë rast është marrë stacioni i policisë në Deçan. Ky automjet ka qarkulluar afër fshatit Baballoq, dhe në lagjen "Agim Ramadani" në Junik. Gjatë verifikimit del se të gjithë ata persona në veturë kanë qenë shqiptarë, dhe nuk ka pasë vend për shqetësim lidhur me këtë. Çdo automjet që hynë në Kosovë, hynë përmes pikave doganore, prandaj nuk ka arsye për shqetësim lidhur me këtë.

Z. Besart Tofaj tha, unë kam disa kërkesa të qytetarëve të shprehura nga takimi me ta, lidhur me shpejtësinë e automjeteve në rrugët e Junikut, pra, si qëndron gjendja me këtë?

Z. Rasim Sylja tha, siç e thash me herët nga rreth dyqind tiketa të shqiptuara shumica janë për tejkalim të shpejtësisë, por dua të cekë se tejkalimi i shpejtësisë ka qenë diku 10 deri në 20 km/h mbi shpejtësinë e lejuar. Pra, nuk kemi pasë ndonjë shpejtësi ekstreme, por megjithatë ne jemi duke punuar, dhe çdo ditë mbajmë pika të kontrollit në terren, ndërsa kemi zero tolerancë ndaj kësaj. Pra, prioritet e kemi sigurinë dhe rregullimin e trafikut rrugorë, dhe çdo ditë në stacionin policor kemi një epror kujdestar për sigurinë në trafik.

Z. Besart Tofaj pyeti se a ka ndikuar ndryshimin e ligjit, pra rritja e gjobave në sigurinë në komunikacion ?

Z. Rasim Sylja tha, kjo ka ndikuar pozitivisht, sepse gjobat janë më të larta dhe policia është më serioze, dhe ne në baza ditore raportojmë për të gjitha veprimet tona.

### **Pika e Katërt e Rendit të Ditës** **Prerja ilegale e pyjeve, gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm**

Z. Tafë Tofaj tha, tani dihet se me ndryshimin e ligjit të ri ne nuk e bëjmë menaxhimin e pyjeve, sepse kompetencat tani kanë kaluar në Agjensionin Pyjor të Kosovës, që menaxhon më të gjitha pyjet dhe parqet kombëtare, si në pyjet e ulëta, ato të larta, dhe bjeshkët në përgjithësi. Por kjo nuk do të thotë se ne si qytetarë dhe institucione të mos interesohemi për gjendjen e pyjeve.

Kemi bërë vizita nëpër pyje, dhe mund të themi se prerjet ilegale janë zvogëluar, por ka prerje ilegale kah ana e Botushës dhe kah rruga e hapur atje ku merret uji, duke përjashtuar prerjen e drunjtëve për hapjen e rrugës, por se paraprakisht nuk është bërë shenjëzimi për prerjen e tyre.

Poashtu, ka prerje edhe kah territori i Komunës së Deçanit, në pjesën kah Vokshi, ku kemi pasë dy njoftime nga qytetarët e Junikut lidhur me këtë. Por ne e kemi të vështirë që të qasemi në atë terren, edhe pse kemi një zyrtar i pylltarisë i cili tani ka kaluar në Agjensionin Pyjor, por i cili nuk ka shumë mbështetje sepse nuk ka as automjet zyrtar në përdorim.

Lidhur me peshkimin ilegal, ne kemi lumin Erenik dhe lumin Trava, të cilët janë të dëmtuar dhe nuk kanë kushte për zhvillimin e peshqve, pra, nuk ka peshkim në këta lumenj.

Z. Ruzhdi Shehu në lidhje me pyjet tha, këtu në këtë takim është dashtë të jenë përfaqësuesit e Agjensionit Pyjor që të pasqyrojnë gjendjen e pyjeve, sepse Komuna nuk ka asnjë kompetencë, dhe as që menaxhon me punëtorët e parkut dhe të pyjeve, ndërsa kërkoj që herëve tjera ata të ftohen në takimet e KKSB-së, dhe kërkoj që të bëhet një raport ku mbikëqyrja dhe menaxhimi i pyjeve dhe Parkut Nacional të ngritët si shqetësim për Ministrinë!

Z. Rasim Sylja tha, çdo institucion e ka obligim që t'i raportoj kryetarit të Komunës për çështjet brenda territorit të asaj komune. Ne jemi duke i prezantuar lëndët të prokuroria e shtetit mbi ndërtime ilegale në bjeshkë, dhe dua të besoj se këto institucione duhet të jenë bashkëpunuese, të mbahen takime dhe të raportohet mbi gjendjen ose kërkesat e parashtruara.

Znj. Leonita Jasiqi tha, neve na kërkohet që t'i plotësojmë pyetësorët dhe raportet, dhe na kërkohet të dihet se sa ndërtime ka në zonat e mbrojtura, dhe sa marrin masa inspektorët e Komunës për parandalimin e ndërtimeve ilegale. Pra, neve na kërkohet të raportojmë për gjërat për të cilat nuk jemi kompetentë, edhe pse ne nuk mbikëqyrim apo menaxhojmë me Parkun Nacional. Prandaj, në pyetësorë dalin si të gjetura, si rekomandime, etj. Pra, nuk po adresohen çështjet në mënyrën e duhur. Ne është dashtë që t'i ngritim këto çështje në takime dhe se këto çështje të mos na dalin në raportet tona, sepse siç e thash edhe me herët, këto nuk janë në kompetencën tonë.

Z. Ruzhdi Shehu tha, ky është një problem serioz që duhet të trajtohet sepse komunat nuk kanë as kapacitete as mandat ligjor lidhur me menaxhimin e pyjeve, lejeve për ndërtim në zonën e bjeshkës dhe mirëmbajtjen e Parkut Nacional.

### **Pika e Pestë e Rendit të Ditës Të ndryshme**

Z. Tafë Tofaj tha, jemi e fazën e zbatimit të projektit për shërimin e kancerit të bletëve. Një ekipë është trajnuar në Zvicër me sukses, dhe kemi dy zyrtarë të certifikuar. Njëri është nga Komuna e Deçanit, ndërsa tjetri nga Komuna e Gjakovës. Tani instituti në Pejë është duke e bërë preparatin antivirus dhe kemi disa parcela ku është bërë injektimi i këtij antivirusi, dhe presim suksese në këtë drejtim.

Z. Rasim Sylja tha, kemi pasur ankesa nga qytetarët për përdorimin e ujit të pijes, ndërsa kërkoj që kompania "Hidrodrini" të caktoj disa rregulla strikte, përndryshe kjo mund të ndikoj në sigurinë, apo mund të shndërrohet në ndonjë pandemi të qytetarëve.

Z. Driton Sylja kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që një shenjë sinjalizuese e komunikacionit që gjendet afër Teqes së Vjetër të ripozicionohet në një vend tjetër, sepse nuk është në vendin e duhur.

Z. Rasim Sylja tha, nëpër disa rrugë të Komunës së Junikut ka disa pengesa nga drunjtë të cilët gjenden ndërmjet këtyre pronave, kryesisht nëpër prona private që paraqesin pengesa dhe rrezikojnë sigurinë në komunikacion, ndërsa kërkoj që të bëhet prerja dhe pastrimi i tyre.

Z. Ruzhdi Shehu tha, për këtë duhet të bëhet shkresë njoftuese dhe bëhet pastrimi i tyre.

Me kaq, koordinatori, z. Besart Tofaj shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKSB-së.

Procesmbajtësi,

\_\_\_\_\_  
Gëzim Geci

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSB-së

\_\_\_\_\_  
Ruzhdi Shehu